PLANI I BIZNESIT KRU "HIDROMORAVA" SH.A. GJILAN 2018-2020

Hidromorava KOMPANIA RAJONALE
Gjilan E UJËSJELLËSIT
HIDROMORAVA Sh.a.
No. 1029 Data 31.10.2017
GJILAN

Hidromorava Gjilan

KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT "HIDROMORAVA" SH.A GJILAN

PLANI I BIZNESIT 2018-2020

P Ë R M B A J T J A

1. HYRJE
1.1 Historiku i kompanisë KRU Hidromorava....3
1.2 Misioni i kompanisë 4
1.3 Risku i kompanisë 4
1.4 Përshkrim i shkurtur i Planit të Biznesit....5

2. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË KOMPANISË....5
2.1 Performanca nga viti 2014 deri 2015....6
2.2 Objektivat e punës 7

3. DEKLARATA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT 7

4. PLANI I MENAXHIMIT TË ASTEVE 8
4.1 Gjendja aktuale e personelit 8
4.2 Nivelet e aftësisë dhe programet e trajnimit 8
4.3 Politika e pagesës (përfitimet , pagesat nxitëse etj)..... ...9
4.4 Programet e Rekrutimit....9

5. DEPARTAMENTI TEKNIK 11
5.1 Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese 11
5.2 Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizmit 13

6. SHERBIMI ME KONSUMATORE 14
6.1 Zgjerimi i zonës së shërbimit 15
6.2 Gatishmëria për të paguar 15

7. PLANI FINANCIAR 16
7.1 Plani i financimit kapital 16
7.2 Kërkesat vjetore operative dhe të hyrat kapitale 17

8. PLANI KOMERCIAL 18
8.1 Politikat dhe programet e Matjes..... 18
8.2 Evitimi i lidhjeve ilegale /fiktive /pasive. 18
8.3 Përmirësimi i faturimit të bazës së konsumatorëve... 19
8.4 Arkëtimi i të ardhurave 19

9. PLANI IINVESTIMEVE KAPITALE : 2017- 2019....21

1.HYRJE

1.1. Historiku i kompanisë KRU Hidromorava

Furnizimi me ujë të pijshëm i qytetit të Gjilanit nga ujësjellësi publik, fillon aty kah viti 1940 me ndërtimin e kaptazhës së parë afër fshatit Koretishtë,e cila gjendet rreth 4 km nga qendra e sotme e qytetit të Gjilanit, me vazhdim të rekonstruimit, zgjerimit e modernizimit të vazhdueshëm, në vitin 1971 filloi projekti për zgjerimin e kapaciteteve të ujit të pijshëm për qytetin e Gjilanit, në pjesën mbi fshatin Përlepnicë, pikërisht në vendin e quajtur 'Guri i Hoxhës'e cila gjendet rreth 5 km nga fshati Përlepnicë. Kështu që në vitin 1978 filloi realizimi i projektit më të rëndësishëm për furnizim me ujë të pijshëm duke ndërtuar Pendën në fshatin Përlepnicë, ku punimet e përfundimit të Pendës kanë zgjatë deri në fund të vitit 1983 ku krahas ndërtimit të Pendës është ndërtuar edhe fabrika për pastrimin e ujit të pijshëm. Krijimit të kësaj ndërmarrje i ka paraprirë ekzistimi i Pellgut të lumit natyror "Morava e Binçës.



Pas përfundimit të luftës ne fund të vitit 1999, Komuniteti Ndërkombëtar me sugjerimin dhe prezencën e Qeverisë së Kosovës filluan procesin e riorganizimit të jetës në Kosovë e në këtë Kontekst edhe organizimin e Ndërmarrjeve Publike duke i shndërruar ato në Kompani Publike dhe duke i regjionalizuar. Komuniteti Ndërkombëtar dhe Qeveria e Kosovës, fillimisht studiuan gjendjet aktuale në të gjithë ujësjellësit e Kosovës, e pastaj në bashkëpunim me shumë partner ndërkombëtar filluan riorganizimin dhe rimëkëmbjen e tyre duke formuar - themeluar 7 (shtatë) Kompani Rajonale të Ujësjellësve dhe Kanalizimit. Në procesin e rimëkëmbjes së Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Hidromorava" në Kosovën Juglindore, partner kryesor shtytës ka qenë Agjencia Zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim - SDC.

I gjithë procesi i rimëkëmbjes dhe zhvillimit ka qenë i monitoruar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) – Divizioni i Ujërave dhe Kanalizimit e cila ishte edhe pronare e Kompanive Publike Kosovare.
AKM-ja me përfundimin e misionit të vetë, në Qershor të vitit 2007, të drejtat pronësore të Kompanive Publike Kosovare ua kaloi Qeverisë së Kosovës përkatësisht Ministrisë së Ekonomisë e Financave (Divizionit të ujërave) - tani Ministria e Zhvillimit Ekonomik.
Kuvendi i Kosovës më 26 Nëntor të vitit 2004 në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/49 ka themeluar Zyrën Rregullatore për Ujë dhe Kanalizim (më tutje ZRRUK).Kjo Rregullore është amendamentuar me Ligjin për Ndryshimin e Rregullores 2004/49 Mbi Aktivitetin e Ofrueseve të Shërbimeve të Ujësjellësit,Kanalizimit dhe Mbeturinave (Nr. 03/L-086) i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës.
Më 13 Qershor 2008 në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ku roli i kësaj zyre është sigurimi i ofrimit të shërbimeve cilësore, efiçiente dhe të sigurta në baza jo-diskriminuese për tërë konsumatorët në Kosovë,si dhe me autorizime dhe përgjegjësi të licencimit të ndërmarrjeve publike që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit e kanalizimit,të ujërave të zeza, përcaktimi i tarifave të shërbimeve të licencuara nga ARRU , aprovimi dhe mbikëqyrja e kartës së Konsumatorëve që rregullon të drejtat dhe obligimet e ndërsjella ndërmjet konsumatorëve dhe Ofruesve të Shërbimeve të licencuara nga ZRRUK ,themelimi dhe mbështetja e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve në shtatë regjionet e Kosovës, e që në pajtim me Ligjin Nr.03/L-086 për punën e vet, ARRU i përgjigjet Kuvendit të Kosovës.
Me qëllim të kontrollit dhe mbarëvajtjes së detyrave të Ndërmarrjeve Publike, Qeveria e Kosovës përkatësisht Ministria e Ekonomisë dhe Financave në vitin 2008 në bazë të Nenit 37 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087 ka themeluar Njësinë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike (NJPMNP), me qëllim të mbështetjes së Ministrit dhe Qeverisë në ushtrimin e përgjegjësive për NP-të të cilat u janë dhënë atyre me Ligj.
NJPMNP,me këto Kompani qeverisë përmes Bordeve (Këshilltarëve) të Drejtoreve, e të cilët Drejtor zgjidhen përmes konkurseve publike.
Kompanitë Kosovare të Ujërave përveç që punojnë në bazë të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike,edhe monitorohen nga institucione të lartpërmendura, ato janë edhe të bashkuara në të ashtuquajturën Shoqata e Ujësjellësve të Kosovës (SHUKOS).

1.2 Misioni i kompanisë

Të sigurojë furnizim me ujë të qëndrueshëm, e të sigurt, në sasi të mjaftueshme dhe me cilësi të duhur, në përputhje me standardet në fuqi, për të gjithë konsumatorët e lidhur në sistem pa dallim race, gjinie dhe religjioni.
Të sigurojë shërbime cilësore të grumbullimit, trajtimit e shkarkimit të ujërave të zeza, për të mbrojtur shëndetin publik dhe në përputhje me standardet e mbrojtjes së mjedisit.
Të investojë në rritjen e kapacitetit të punonjësve të saj dhe tu siguroj atyre një kompensim të përshtatshëm për të motivuar interesin e tyre në sigurimin e shërbimeve cilësore në ambientin ku punojnë.
Të përmirësojë në mënyrë të qëndrueshme përformancën financiare të kompanisë, në mënyrë që të përparojë në rritje në drejtim të arritjes së qëndrueshmërisë së plotë financiare të operimeve të kompanisë dhe për ta bërë atë të aftë të marrë kredi për investime kapitale.

Misioni i përgjithshëm i Kompanisë është që të siguroj ujë të pijshëm, cilësor dhe të mjaftueshëm për të gjithë konsumatorët

1.3. Risku i kompanisë

Zbatimi i misionit të Kompanisë mund të përcillet me rreziqet eventuale të natyrave të ndryshme si:

- Mungesa e ujit në burime si pasojë e mungesës së reshjeve atmosferike
- Mungesa e donatorëve potencial në financimin e projekteve investive
- Fatkeqësitë natyrore, etj.

1.4. Përshkrim i shkurtur i Planit të Biznesit

- Kompania Rajonale për ujë dhe kanalizim Hidromorava Sha.A është institucion publik i licencuar nga Autoriteti per Ujë dhe Kanalizim për ofrimin e shërbimeve me ujë të pijshëm dhe shërbimet e kanalizmit.
- Ky plan definon qartë orientimet zhvillimore të Kompanisë dhe definon qartë objektivat dhe rezultatet e pritshme duke marrë për bazë edhe rezultatet e arritura në periudhën paraprake.
- Plani është përgatitur duke pasur parasysh gjendjen ekzistuese të Kompanisë , trendin e zhvillimit të sektorit të ujit në Kosovë për të adoptuar praktikat më të mira të njohura për një zhvillim të qëndrueshëm të Kompanisë. Por gjithashtu është marrë për bazë edhe ambienti ekonomik dhe social në Republikën e Kosovës.
- Plani i Biznesit 2018-2020 definon qartë rrugën e zhvillimit të Kompanisë duke marrë parasysh përparësitë dhe rreziqet për realizimin e suksesshëm që do të rezultojë me një arritje të vetë qëndrueshmërisë financiare të Kompanisë. Parametrat financiar dhe operativ janë analizuar në mënyrë që të jenë të arritshme (duke lënë mundësinë e tejkalimit të të njëjtave – uljen e tyre) pa e dëmtuar funksionimin dhe ofrimin sa më cilësor të shërbimeve ndaj konsumatorëve, të jenë sa më afër realitetit dhe parametra të arritshëm.
- Plani i Biznesit është i orientuar fuqishëm në drejtim te mundësive vetanake financiare dhe Donatorëve ku realizimi sidomos i Planit të investimeve kapitale është i varur edhe nga përkrahja që do të sigurohet nga Donatorët , institucionet qendrore dhe lokale .
- Bordi i Drejtorëve, Menaxhmenti si dhe të gjithë të punësuarit do të jenë të angazhuar maksimalisht që me punën e tyre të realizojnë objektivat që dalin nga ky Plan, në mënyrë që Kompania të arrijë një qëndrueshmëri financiare që të ofrojë shërbime cilësore për konsumatorët.

2. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË KOMPANISË

Kompania, e cila përbëhet nga Qendra Regjionale në Gjilan dhe dy njësitë operative Viti dhe Kamenicë , funksionon me vendimmarrje dhe llogaridhënie Bordit të Drejtorëve dhe Autoritetit Qëndror , në përputhshmëri me principet e qeverisjes korporative . Bordi i drejtorëve dhe Ekzekutivi i KRU-së Hidromorava Sh. A. për periudhën 2018-2020 ka përcaktuar qëllimet kryesore strategjike në vijim:

- Furnizimin me ujë të të gjithë konsumatorëve, përfshirë edhe ata në pikat e larta.
- Ruajtja e kualitetit të ujit të pijshëm në pajtim me standardet e IKSHP
- Arritjen e vetëqëndrueshmërisë financiare
- Promovimin e relacioneve të mira me konsumatorë.
- Adoptimin e politikave tarifore të ARRU-së për arritjen e të ardhurave të mjaftueshme që do të mund të mbulojnë shpenzimet operative dhe investimet e domosdoshme.
- Sigurimin e shfrytëzimit racional të burimeve të ujit.
- Krijimin e një ambienti të favorshëm të punës.

Për realizimin e qëllimeve kryesore strategjike, për vitin 2018 Kompania ka paraparë përmbushjen e objektivave strategjike në vijim:

Tregues Kryesore Performances	Njësia]	2016	2017	2018	2019	2020
Ujë i pafaturuar-si përqindje	%	57.92	56.34	49.44	48.00	47.00
Norma e arkëtimit - e përgjithshme	%	77.83	83.00	83.40	84.50	85.50
Norma e arkëtimit – Amvisëritë	%	73.00	80.00	81.00	82.00	82.50
Norma e arkëtimit -Jo-Amvisëri	%	90.00	97.00	98.00	98.00	99.00
Norma e punës	Numër	1.44	1.39	1.41	1.43	1.44
Norma e Mbulesës së Punës	Numër	1.12	1.13	1.17	1.25	1.31
Përqindja e konsumatorëve me lexim	%	90.00	90.60	92.00	93.00	94.00
Staf per 1000 konsumatorë	Numër	5.97	5.47	5.40	5.39	5.35

2.1 Performanca nga viti 2016 deri më 2019

	Performancat e KRU "Hidromorava" SHA-Gjilan X1000 m^3 dhe X1000€	2016	2017	2018	Dallimi: +rritje /-zvoglim
1	**Prodhimi I ujit m^3**	**8,187**	**8,584**	**8,781**	**+2.29**
2	**Faturimi ujit ne m^3**	**3,602**	**3,762**	**4,439**	**+17.99**
3	**Faturimi €**	**1,855**	**2,082**	**2,441**	**+17.24**
4	**Arkëtimi €**	**1,434**	**1,728**	**2,026**	**+17.24**
5	**Përqindja e arkëtimit**	**77.33**	**83.00**	**83.40**	**+0.40**
6	**Shpenzimet €**	**1,495**	**1,612**	**1,761**	**+ 9.24**
7	**Numri total i konsumatorëve**	**27,600**	**28,800**	**30,000**	**+4.16**
8	**Numri i konsumatoreve me fatura te leshuara**	**24,929**	**26,049**	**27,453**	**+5.38**
8	**Numri i konsumatorëve me UM**	**22,105**	**22,620**	**25,081**	**+10.87**

9	**Përqindja e konsumatorëve me UM**	**90.00**	**90.05**	**91.35**	**+ 1.3**
10	**Përqindja e faturimit për vit**	**43.00**	**53.00**	**49.44**	**-3.56**
11	**Uji i pa faturuar (Humbja)**	**57.00**	**47.00**	**50.56**	**+3.56**
12	**Norma e Mbulimit te Punës**	**1.01**	**1.13**	**1.17**	**+3.54**

Prodhimi per vitin 2017 eshte planifikuar te jete 8,871,000 m^3 ndersa faturimi 4,439,370 m^3, po ashtu edhe arketimi eshte planifikuar te jete 2,028,918 €.
Plani i inkasimit për vitin e ardhshëm do të jetë 83.40 %, këtë normë duhet ta arrijmë me angazhimin e te gjitheve e sidomos me stafin e ekipit për shkyçje tek konsumatorët qe nuk i kryejn obligimet për ujin e shpenzuar, dhe sigurisht qe do ti perdorim strategji te ndryshme rreth organizimit te arketimit të mjeteve .

Performanca operative

KRU.Hidromorava SH.A.	
Treguesit Operativ	Pl Biznesi 2018
Prodhimi i ujit ne m3	8,871,000
Faturimi i ujit (%)	49.44
Arketimi i ujit (%)	83.40
Uji i pafatururar (%)	50.56
Testet e deshtuara (%)	2
Konsumatore me Ujemates (%)	91.35
Numri i Konsumatorve	30,000
Numri i punetorve	158

Performanca financiare

KRU.Hidromorava SH.A.	
Treguesit Finanaciar	Pl Biznesi 2018
Te Hyrat	2,335,412
Shpenzimet	1,826,420
Fitimi/Humbja Financiare	508,992
Zhvlersimi dhe Amortizimi	570,000
Borxhet e keqija(falura)	422,200
Të ardhurat (humbjet) neto	-483,208
Paraja ne fund vitit	270,300
Mjetet themelore	8,994,750

2.2 Objektivat e punës

Gjatë periudhës planifikuese 2018 janë planifikuar te shtohen gjithsej edhe 4,450 konsumator te rinje qe përfshijën komunat Novobërdë , Partesh , Rranillug , Kllokot dhe do të regjistrohen brenda zonës rurale , si dhe regjistrimi i konsumatorëve ilegal të cilët mund të legalizohen si në zonën rurale ashtu edhe në urbane.
Tabela në vijim tregon rritjen e numrit të konsumatorëve sipas viteve.

Tabela 1. Rritja e planifikuar e numrit të konsumatorëve ne KRU "Hidromorava"ShA Gjilan

Vitet	2018	2019	2020
Konsumator nga kyçja e fshatrave	380	4,600	4,200
Konsumatorët tjerë të rinj	920	700	700
Totali	1,300	5,300	4,900

3. DEKLARATA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT

Kompania Rajonale e Ujësjellsit Hidromorava Sh. A do të zbatojë tarifën që vendos Autoriteti Rregullativ për Ujë dhe Kanalizim, si autoritet kompetent në bazë të Ligjit mbi Veprimtarinë e ofruesve të shërbimeve të ujësjellesit dhe kanalizimit. Në bazë të tarifës aktuale , duke marre në konsideratë edhe shkallën e arkëtimit dhe nivelin e humbjeve komerciale dhe teknike mund bëhet në tërësi vetëm mbulimi i kostove operative por jo edhe financimi i investimeve kapitale në atë shkallë siq ne e planifikojme . Tarifat ekzistuese nuk sigurojne investime më të mëdha kapitale drejt rritjes së bazës materiale dhe sherbime më të mira për konsumatorë pa përkrahjen nga donatorët , institucionet qëndrore dhe lokale. Zbatimi i rritjes së tarifës ne vitet e ardhshme do të në mundësoj që ti arrijmë më sukses përmbushjen e caqeve të kompanise tonë, dhe sigurisht që kjo rritje do të kete efekt pozitiv edhe në rritjen e kursimit të ujit në dobi të kosumatorëve.

	Tarifa	Kategoria e konsumatorëve	2017	2018
1	Tarifa për ujë/m^3	Konsumatorët shtëpiak- amvisnit	0.33 €	**0.35 €**
2.		Konsumatorët jo shtëpiak- bizneset/ institucionet	0.65 €	**0.68 €**
3.	Tarifa për ujëra të zeza/m^3	Konsumatorët shtëpiak- amvisnit	0.08 €	**0.08€**
4.		Konsumatorët jo shtëpiak - bizneset / institucionet	0.20 €	**0.20 €**
5.	Taksa fikse	Konsumatorët shtëpiak- amvisnit	1.00 €	1.00 €
6.		Konsumatorët jo shtëpiak- bizneset / institucionet	3.00 €	3.00 €

4. PLANI I MENAXHIMIT TË ASETEVE

Kompania udhëhiqet nga Kryeshefi Ekzekutiv në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me Zyrtarin e Lartë Financiar , Shefin e Operatives teknik, Sekretarin e Kompanisë , Zyrtarën e Auditimit te Brendshëm dhe zyrtarët e tjerë të nivelit të tretë të menaxhimit (në pajtim me Ligjin e cituar).

4.1. Gjendja aktuale e personelit

Aktualisht KRU" Hidromorava" Sh.A. Operon me 154 punëtorë në regjion, 115 në Qendrën Regjionale Gjilan, Viti 20 dhe Kamenicë 19 ,i ndarë në tre Departamente Teknik , Financiar dhe në Administratë. KRU "Hidromorava"Sh.A. ka këtë strukturë të të punësuarve:

Nr.	Kualifikimi i stafit te KRU "Hidromorava"ShA Gjilan	Numri			
		Gjilan	Viti	Kamen	Totali
1	Magjister (Mr.Sc)	1	-	-	1
2	Master	3	-	-	3
3	Me fakultet	13	-	2	15
4.	Bachellor-shkolla e larte	8	2	-	10
5	Shkolla e mesme	57	14	7	79
6	Punëtorë të kualifikuar	12	2	7	21
7	Punëtorë të pakualifikuar (shkolla fillore)	21	2	3	26
	Totali	**115**	**20**	**19**	**154**

4.2 Nivelet e aftësisë dhe programet e trajnimit

Riorganizimi i punës, transferimi i punëtorëve në shërbime të planifikuara, ndryshimet e vazhdueshme strukturore që kanë si synim fleksibilitet më të madh në punë dhe përshtatje me mjedisin e punës janë treguesit kryesor që trajnimi dhe zhvillimi stafit të jetë një proces I vazhdueshëm me ndikim pozitiv në rritjen e efikasitetit të kompanisë së KRU "Hidromorava" SH.A. përmes këtij procesi synohet të arrihet një përmirësim e aftësive dhe një kualifikim profesional i punëtorëve, sepse çdo punë ka specifikat e veta.

KRU "Hidromorava"Sh. A në nivel të kompanisë do të organizojë brenda sektorëve trajnime për punëtorët nga përgjegjësit e sektorëve dhe nga ana e drejtuesve të departamenteve në vazhdimësi.

Po kështu është menduar që të organizohen edhe trajnime në dimensionin e ngritjes së shërbimit financiar dhe atyre teknik në nivel të Shoqatës së Ujësjellësit dhe Kanalizimit të Kosovës siç janë organizuar edhe më parë. Nevojat e trajnimeve janë evidente si në menaxhment ashtu edhe në sektorët financiar, teknik dhe administrativ ku trajnimi është I nevojshëm për njohjen e rregulloreve dhe akteve juridike me qëllim që të mos bien ndesh me problematikën e kompanisë .

Gjatë vitit 2017 do shikohet mundësia e organizimit të trajnimeve menaxheriale si p.sh, Menaxhimit Modern të Resurseve Njerëzore, Gis, Mirëmbajtjen e rrjetit të furnizimit me ujë, Gjetjen e humbjeve në rrjet, Menaxhimin e Sistemit Informativ, ku edhe disa trajnime tjera.

4.3 Politika e pagesës (përfitimet, pagesat nxitëse etj)

Qëllimi i vlerësimit të performancës është gjetja e pikave të forta e të dobëta të punonjësve. Promovimet apo gradat jepen në bazë të krahasimit të performancës aktuale me atë të dëshiruar.

Mirëpo ,për shkak te situatës financiare jo të favorshme të kompanisë jemi detyruar që të mos zbatojmë pagesat stimuluese tek stafi i kompanisë por vetëm aty ku është menduar që do të ndikojnë më së shumti në ngritjen dhe përmirësimin e situatës financiare në të cilën ndodhet kompania.

Gjithashtu si politikë stimuluese e kompanisë që planifikohet të zbatohet është edhe çertifikimi për kualifikim adekuat të punëtorëve në sferën e shërbimit teknik .

4.4 Programet e rekrutimit

Suksesi dhe përshtatshmëria e një kompanie varet nga rekrutimi i punonjësve, të cilët janë fleksibël, të adaptueshëm dhe të përkushtuar në suksesin e kompanisë.
Deri më tani kemi zbatuar plotësimin e pozitave të lira si nga brenda ashtu edhe nga jashtë.
Prandaj KRU"Hidromorava"Sh.A. në planifikimin e saj parasheh që në të ardhmen për shkak të rritjes së numrit të konsumatorëve dhe vëllimit të punëve të bëjë rekrutimin e punonjësve të rijë të cilët janë të nevojshëm për sektorët e veçanta në kuadër të kompanisë.
Një tregues i rëndësishëm për të llogaritur kërkesat për staf është numri i stafit që duhet të shërbejë si normë për staf sipas standardeve ku ky tregues sillet deri në 6 punëtorë për 1000 lidhje (treguesi I efikasitetit te kompanise), ne vitin 2018 kompania planifikon që të punësoj , një Gjeodet i Diplomuar për Zyren e GIS –it , në kuadër të departamentit teknik ,kështu që numri i të punësuarve për vitin 2018 do të shkoj në 158 punëtor.
Një prej faktorëve që esencialisht ndikon në performancën dhe zhvillimin efikas të kompanisë është struktura e organizative. Mjedisi i brendshëm i punës është faktorë influencues në funksionimin e kompanisë.
KRU"Hidromorava"Sh.A, ka përgatitur skemën funksionale e cila përputhet me strategjinë zhvillimore sepse rolet dhe përgjegjësit janë të specifikuara mirë, Struktura e përgatitur do të prodhoj efikasitet në perspektivën e menaxhimit të kompanisë ashtu siç është paraqitur në skemën organizative të paraqitur më poshtë:
Skema organizative është miratuar nga Bordit të Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur më 30 Tetor 2017, dhe kjo skema të mund të ndryshojë vetëm në rast të ndryshimeve të domosdoshme


Bordi i Dreitoreve KRU Hidromorava
Komiteti i Auditimit
Zyra Ekzekutive Zedhenesi, Asistenti teknik, Vozitesi
Kryeshefi Ekzekutiv
Zyrtari i Auditimit te Brendshem
Dep. Administ. Sek r e t a ri
Departamenti Financiar Zyrtari i lartë Financiar
Zyra e Prokurimit
Furnizuesi
Departamenti i Teknik Shefi i Operatives
Zyra e GIS-it Menaxhimi i aseteve
Zyra per resurse njerezore
Zyrtar Ligjor
Zyra për mbrojtje ne – punë
Siguria fizike për Administratë Qëndrore
Autoparku dhe Mekanizimi
Mirëmbajtja e Higjineës
Shefi i kontabilitetit
Kontisti Sintetik
Kontisti Analitik
Zyrtari per Mjete Themelore
Arkatari-Portoarkat
Depoisti
Zyra per Konsumator
Zyra e faturimit
Pergjegjesi i ekipeve të çkyqjes
Pergjegjesi i inkasanteve
Pergjegjesi i lexuesve
Pergjegjesi i inspektimit
Ekipet e çkyqjes
Inkasantet
Lexuesit
Ekipi i inspektimit
Njesia Operative- VITI
Puntoria e ujematesv e ne VITI
Njesia operative Gjilan
Njesia Operative- Kamenicë
Inxhinier / Opertaiva
Operimi dhe mirembajtjes se rrj. Ujes.
Operimi dhe Mirembaj. e rrje. të kanal.
FPU – Letnicë
Klientelë & Faturimi
Arka
Depoisti
Inkasantët
Ekipi i çkyqjes
Njesia per elektro-mekanike
FPU-Përlepnica& Guri I Hoxhes
FPU-Velekinca GJ
Stac. Baja& Paisjet elektromeka nike dhe Rezervuare
Kualiteti i ujit
Kontrolli kimiko-fizike
Kontrolli bakterologjik
Rrjeti I ujesjellsit
Njesia per zvoglimin e UPF Viti
Ekipi per detektimin e humbjeve
Ekipi per Operim& mirembajte
Zyrtare ne zyren teknike
Rrjeti I Kanalizimi
Operimi dhe Mirembjtja e rrjetit të Kanaliizmit
Inxhinier / Opertaiva
Operimi dhe Mirembajta e rrje. të ujësjellësit
Operimi dhe Mirembajta e rrje. të kanalizimit
-Prodhimi I ujit Stacionet e pompimit & Kontrolli
Klientela & Arka
Faturimi
Depoisti
Inkasantet
Ekipi i çkyqjes
Higjienisti
Gjithsej 158 punetore

5. DEPARTAMENTI TEKNIK

Kapaciteti mesatar i prodhimit te ujit [m^3] 2016	
FPU Perlep. dhe G. Hoxhes	436,844.0
FPU Velekince	80,165.9
Pasjane	7,649.3
Baja	39,240.8
Malisheva e Ulte	4,068.3
Malisheva e Eperme	1,215.0
Doberqane	6,571.7
Llovce	508.3
Zheger	11,584.2
Letnica- Viti	37,142.8
Pozhorani	8,913.5
Stac. pomp. 1, Kamenice	43,450.0
Stac. pomp. 2, Kamenice	6,363.3
Stac. pomp. 3, Kamenice	2,345.4
	686,062.5

Nga tabela shihet se gjate vitit 2016 eshte prodhuar gjithesej 8232750m^3 apo me nje mesatare prej 686062.5m^3 ne muaj. Me kete sasi te prodhuar te ujit te prodhuar KRU Hidromorava përmes Departamentit teknik gjate vitit 2016, ka arritur që me sukses të furnizojë konsumatorët me uje te pijes brenda zones se sherbimit dhe pa ndonjë redukim te planifikuar. Nje furnizim i qendrueshem me uje per konsumatoret brenda zones sherbimit ka vazhduar edhe gjate 9 muajve te vitit 2017, poashtu nje gje e tille pritet te ndodhe edhe per tre muajt e mbetur te ketij viti bazuar edhe ne Planin per Menaxhimin e thatesires per vitin 2016/2017. Liqeni i Perlepnices si burimi kryesor i furnizimit me uje per qytetin e Gjianit por edhe per disa fshatra, per gati gjithe kohen niveli i ujit ka qene afer kuates maksimale dhe kjo ka qene edhe arsyeja kryesore e nje furnizimi stabil te konsumatoreve me uje te pijes. Edhe burimet te tjera te cilat jane te shperndara ne dy komunat te tjera dhe qe menaxhohen nga KRU Hidromorava kane qene stabile



5.1 Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese

Kompania furnizon me ujë të pijshëm regjionin e Gjilanit, Vitisë dhe Kamenicës duke përfshirë edhe pjesët rurale.

Qyteti i Gjilanit furnizohet me ujë të pijshëm i cili merret nga:

- Akumulacioni i Perlepnicës dhe kaptazha te 'Guri i Hoxhës'. Uji trajtohet në Fabrikën për Përpunimin e Ujit në Perlepnicë me kapacitet të përpunimit të ujit prej 150- 160l/s.
- Pellgu i Lumit Morava në Veleknicë. Uji trajtohet në Fabrikën për Përpunimin e Ujit në Veleknicë me kapacitet të përpunimit të ujit prej 50-60l/s.
- Burimi 'Baja'. Uji trajtohet në stacionin e pompimit në Banjë me kapacitet maksimal të përpunimit të ujit prej 30-40l/s.

Qyteti i Vitisë furnizohet me ujë të pijshëm i cili merret nga:

- Burimi Letnica. Uji trajtohet në Fabrikën për Përpunimin e Ujit në Letnicë me kapacitet maksimal të përpunimit të ujit prej 15-20 l/s.

Qyteti i Kamenicës furnizohet me ujë të pijshëm i cili merret nga:

- Puset që gjenden në dy zona. Uji trajtohet (klorinohet) në Stacionin e Pompimit I dhe II me kapacitet maksimal të pompimit të ujit prej 20-25 l/s nga të dy stacionet.

Sistemet rurale brenda zones se sherbimeve:

- Puset dhe stac. pompimit që gjenden në zonen e sherbimit me kapacitet maksimal të pompimit të ujit prej 10-15 l/s ne total.

Strategjia e KRU Hidromorava per zvogelimin e UPF-se

Duke mare parasyshe se uji I pafaturuar edhe me tutje eshte I larte, menaxhmenti I kompanis ka planifikuar qe gjate vitit 2018 te planifikoje masa te shtuara te aktiviteteve te cilat do te qojne ne nje kontrolle te prodhimit te ujit dhe ati qe do te faturohet.
Prioriteti kryesor i Kompanive në zvogëlimin e UPF është reduktimi i humbjeve komerciale ngase mendojme se pikrisht sasia me e madhe e humbjeve te pergjitheshme I takojne kesaj kategorie. Luftimi me sukses i këtyre humbjeve paraqet sfidë për menaxhmentin e KRU Hidromorava dhe presupozon ballafaqimin me sukses me tri elementet menaxhuese:

- Menaxhimin e resurseve njerëzore (punëtorëve)
- Menaxhimin e resurseve fizike (pajisjeve, para së gjithash ujëmatësve)
- Menaxhimin e resurseve organizative (procedurat

Reduktimi i këtyre humbjeve nuk kërkon investime financiare të larta por para se gjithash kerkon nje përkushtim maksimal të menaxhmentit dhe prandaj mund të arrihen rezultate të konsiderueshme përmes ndërmarrjes së masave si: inspektimi dhe detektimi i kyçjeve ilegale dhe vjedhjeve të ujit, shkyçja/legalizimi i personave të kyçur ilegalisht ose që vjedhin ujin, instalimi i ujëmatësve aty ku mungojnë, inspektimi i rregulltë dhe zëvendësimi i ujëmatësve jofunksional, ngritja e saktësisë dhe përgjegjësisë në leximin e ujëmatësve, etj.

Kualiteti i ujit te pijshem ne kuader te Zones se Sherbimit

Kualiteti i ujit të pijshëm i shpërndarë në tërë zonën e shërbimit monitorohet rregullisht nga ekipet e specializuara te KRU Hidromorava ne Gjilan por edhe nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike.
Me qellim te permbushjes se standardit sa me kualitativ per nje kontrolle efikase te ujit te pijes, KRU Hidromorava ka planifikuar qe gjate vitit 2017 te ndertoje laboratorin kryesor ne Gjilan perballe objektit Qendror te KRU Hidromorava qe ka te beje me analizat kimiko-fizike dhe bakteriologjike.
Ndertimi i ketij laboratori do te mundesoje edhe nje kontrolle me efikase ne kohen kur KRU Hidromorava planifikon zgjerimin e zones se sherbimit edhe me 4 komuna te reja, marreveshjet me te cilat veq jane nenshkruar.

Siq dihet permes investimeve te Qeveris Zvicerane dhe asaj te Kosoves eshte duke vazhduar implementimi i projekteve per rehabilitimin e ketyre sistemeve te ujesjellesit qe jane te shperndara ne 7 komunat e rajonit te anamoraves dhe shpejt priten qe keto sisteme te jene pjese e KRU Hidromorava ne Gjilan.

Riparimi i rrjedhjeve sipërfaqësore

Departamenti i Teknik ashtu sikur kishte planifikuar ka jetesuar një sektor te veqant qe ka te beje me zvogelimin e ujit te pafaturuar permes aktiviteteve te operimit preventiv. Ky aktualisht ky sektor perbehet nga nje inxhinjer dhe nje ekip i specializuar per detektimin e humbjeve te ujit ne zonen e sherbimit. Ky sektor ne bashkepunim me zyren e GIS-it, ekipin e mirembajtjes se rrjetit te ujesjellesit por edhe departamentin financiar e sidomos sektorin e leximit te ujematesve kordinin aktivitetet ne teren te cilat do te rezultonin me rezultate konkrete ne zvoglimin e ujit te pafaturuar.

Identifikimi i rrjedhjeve nëntokësore
Të njëjtat ekipe (të përfolura më lartë) do të angazhohen po ashtu në identifikimin dhe riparimin e rrjedhjeve nëntokësore të ujit.

Metodat e parapara për detektimin e rrjedhjeve nëntokësore do të jenë:
Përdorimi i detektorëve sonik dhe Inspektimi vizual i pusetave të kanalizimit gjatë periudhës së natës kur shpenzimi i ujit është shumë i vogël.

Rivitalizimi i gypave te rrjetit te ujesjellesit

KRU Hidromorava Sh.A ne Gjilan per disa vite ka arritur te perfitoje projekte per nderrimin e gypave te ujesjellesit nga MZHE ne vlere te konsiderushme financiare. I gjithe rrjeti i zevendesuar ishte nga AÇ dhe eshte zevendesuar me me gypa PE-RC. Keto investime kane ndikuar direkt ne permiresimin e furnizimit me uje te konsumatoreve, uljen e ujit te pafaturuar, shenzimet e financiare te mirembajtjes, etj.
Fale ketyre investimeve te bera nga Qeveria dhe donatoret, e nje pjese te realizuar edhe nga mjetet vetanake te kompanis sasia e gypave te Azbest cement jane zvogeluar dukshem dhe nuk kalon 20% nga sasia e pergjitheshme e gypave ne zonen e sherbimit.
Vlen te zeket se ne kuader te revitalizimit te rrjetit te ujesjellesit eshte edhe nderrimi i gypit qe transporton ujin nga fabrika ne Letnice per qytetin e Vitis me nje gjatesi 10 000 m'. Investimi eshte i perbashket ne mes qeveris Zvicerane dhe Komunes se Vitis.
Vjetërsia e gypave te mbetur ne sistemin e ujesjellesit brenda zones se sherbimit edhe me tutje e vështirëson furnizimin me ujë të konsumatorëve prandaj Kompania planifikon që gjatë periudhës planifikuese 2018, të rivitalizoj- ndërroj (në emër të mirëmbajtjes) rreth 20 000 euro vlere te investimeve vetanake. Poashtu, projekte te tilla jane parapa ne kuader te investimeve kapitale te planifikuar per vitet 2018-2020 kryesisht nga burimet e jashtem (Qeveria e Republikes se Kosoves apo donacionet).

5.2.Mirëmbajtja e rrjetit te kanalizimit

Kompania po ashtu do të kujdeset për largimin e ujërave të zeza të qyteteve të Gjilanit, Vitisë dhe Kamenicës. Ujërat e zeza të qytetit të Gjilanit përmes dy kolektorëve kryesor do të derdhen në lumin Morava, pa ndonjë trajtim. Ato të qytetit të Vitisë përmes kolektorit kryesor do të derdhen në lumin Morava, ndërsa ato të qytetit të Kamenicës përmes kolektorit do të derdhen në lumin Krivareka po ashtu pa ndonjë trajtim.
Kompania për te ardhmen do ti kushtoje shume me shume rëndësi sektorit te kanalizimit si në investime po ashtu edhe ne organizim ne mënyrë qe ky sektor te jete shume me efikas se deri me tani. Punët qe priten te kryen nga këto ekipe janë:

- Nr. Pusetave te kanalizimit te inspektuara
- Nr. Pusetave te kanalizimit te riparuara(riparimi, vendosja e kapakëve etj.)
- Nr. Pusetave te kanalizimit te debllokuara- pastruara

Eshte shume e rendesishme te ceket se gjate vitit 2018 do te fillohet me ndertimin e kolektoreve kryesor te kanalizimeve per qytetin e Gjilanit me rrethine, investim qe planifikohet te realizohet permes kredis nga Qeveria e Republikes se Kosoves. Ne kuader te ketij investimi eshte parapa edhe sigurimi i dy auto- cisternave dhe nje eskavatori te cilat do ti dorezohen kompanis si lehtesim per mirembajtje te rrjetit te kanalizimit.

Për sa i përket trajtimit te ujerave te zeza ende nuk ka ndonjë planifikim te detajuar përpos studimit te fizibilitetit te mbeshtetur financiarisht nga realizuar nga Komisionit Europian.
Ne vitet ne vijim sigurisht se ndertimi i fabrikes per trajtimin e ujrave te zeza do te jetë një nga prioritetet kryesore te kompanisë po ashtu edhe ai komunal dhe qeveritar, ngase lidhet direkt me politikat ambientale.
Sipas planifikimit mendohet se impianti për trajtimin e ujërave te zeza do te vendoset ne lokacionin e fshatit Uglari pikë e cila do te mundësoj grumbullimin e gjithe kolektoreve ne nje pike permes gravitet.

Sistemi i furnizimit me uje te Gjilanit

Skema hidraulike



6. SHËRBIMET PËR KONSUMATORË

Gjatë vitit 2017, krahasuar me vitin 2016, numri i konsumatorëve të regjistruar është rritur për 802 si rezultat i shtrirjes së zonës së shërbimeve ndersa ne vitin 2018 veten ne zonen urbane parashihet rritja e numrit te konsumatoreve edhe për 1200 konsumatore duke u angazhuar ne identifikimin e lidhjeve ilegale permes inspetimeve ne teren . Në këtë rritje kane ndikuar kyqjet ne banesat kolektive edhe angazhimi i ekipit për verifikimin e konsumatorëve a janë të kyçur në rrjetin e ujësjellësit, nga informatat të cilat i siguronin punëtorët të cilët hasnin edhe në konsumatorë ilegal, Në vitin 2018 identifikimi i konsumatorëve ilegal ka me qene më i lehtë se kemi sistemin e GIS-it në funksion të plotë, ku me ndihmën e lexuesve dhe punëtorëve tjerë nga tereni do të identifikohen të gjithë ata të cilët e përdorin ujin e pijshëm të ujësjellësit në mënyrë të pa autorizuar-ilegale.

Kompania në vitin 2018 do të përdor metoda të ndryshme për rritjen e vlerës së arkëtimit, presion te vazhdueshem ndaj konsumatoreve me borxhe , angazhimin e permbaruesit privat , mudesin e riprogramimit te borxheve me qellim te futjes ne sistem pagese te gjithe konsumatoret me obligime , ndër to edhe shkyçjen e konsumatorëve te cilet nuk u jane permbajtur detyrimeve per uje si dhe marrevshjes ne baze kontrates mbi faljen e borxheve . Shkyçjet do të asistohen edhe nga Policia e Kosovës-Gjilan me te cilen do te kemi marreveshje me shkrim per te na mbeshtetur ne rastet kur na paraqitet nevoja . Gjitheashtu edhe kosnumatoret te cilet nuk lejojne shkyqjen teknike ne do ti procedojme permes Gjykates Kompetente ne Gjilan .

Në vitin 2018 pritet që të rritet numri i konsumatorëve në 30,000 kosnumatoreve , e kjo rritje do të ndikoj në rritjen e faturimit të ujit të prodhuar, për dhe me aktivitetet e shtuara në identifikimin e kyçjeve ilegale, me legalizimin e tyre dhe eliminimin e lidhjeve të dyfishta do të zvogëlohet humbja e ujit të prodhuar per 6 % gjegjësisht do të faturohen 50.56 % e ujit të prodhuar. Ky plan mendojme te arrihet permes nje plani strategjik te cilin kemi filluar ta aplikojme dhe synim i yni eshte te arrijme ne nje % relativisht të larte te pllombimit të gjithë Ujematesve në mënyrë që të pengohet manipulimi nga konsumatorët e papergjegjshëm

Në vitin 2018 kompania planifikon që shkalla inkasimit të jetë 83.40 %, kjo normë do tëshenoj nje ngritje prej 5 % nga norma e realizuar per vitin 2017.

Por në vitin 2018 do te mundohemi ta funksionalizojmë leximet dhe arketimet permes paisjeve mobile ne menyre qe operimi te jete me efikas dhe i shpejt ku do te na kursen si kohen ashtu edhe shfrytezimin sa me racional te stafit ekzistues dhe ma krijon hapsire dhe kushte per organizimin i ekipeve dhe inspektoreve ne teren qe do ta rrisin shkallen e efikasitetitit dhe ngritjen e pergjegjesise te te gjithe staffi punonjes.

6.1 Invetimet e realizuara gjate vitit 2017

Ka vazhduar Programi Mbështetës për Ujësjellës dhe Kanalizim në Viset Rurale faza-V i cili zbatohet nga asociacioni i përbashkët Dorsch Group (nga Gjermania) dhe CDI (nga Kosova) dhe financohet nga Qeveria Zvicerane dhe Qeveria e Kosovës. Qëllimi parësor i ***Programit Mbështetës për Ujë dhe Kanalizim në Zonat Rurale Faza e V-të***, që bashkë-financohet nga Qeveria e Zvicrës përmes Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) Zyra në Kosovë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Ministrisë së Financave" është rehabilitimi

teknik i sistemeve të furnizimit me ujë që është edhe parakusht për integrimine tyre nën ombrellën e KRU "Hidromorava". **Plani i veprimit për integrimin e skemave të ujësjellësve të komunave**

Aktualisht ky projekt eshte ne fazen e rehabilitimit te sistemeve ne fazen e pare te tenderimit qe parashihen rehabilitimi i i puseve, kaptazhave, stacionet e pompimit, rezervuaret e ujit dhe stacionet e dezinfektimit. Ne fazen e dyte te tenderimit do te hyne punet e rehabilitimit te rrjetit, kyqjet montimi i ujematesve etj. Pas ketyre aktivitetev planifikohet integrimi i plote i ketyre sistemeve ne kuader te KRU Hidromorava Sh.A Gjilan.

6.2. Gatishmëria për të paguar

Problemi me i ndjeshëm i kompanisë është shkalla jo e kënaqshme inkasimit nga konsumatorët, mundësia dhe vetëdija jo e lartë konsumatorëve për te paguar ujin e harxhuar.
Kompania do të jetë në vazhdimësi e detyruar qe te aplikoje masa më të ashpra për ti detyruar konsumatorët ti bëjnë pagesat e tyre.
Problem për mos pagese te ujit te harxhuar do të ketë nga kategoritë e konsumatorëve shtëpiak-amvisëritë, bizneset e vogla dhe institucione.
Kjo përqindje jo e kënaqshme e inkasimit te kategoria e konsumatorëve-shtëpiak është shtrenjtimi –rritja e kostos së jetesës.
Te bizneset e vogla problem i mos pagesës është se shpesh ndërrohen shfrytëzuesit e lokaleve të cilët nuk po mund të stabilizohen me bizneset e tyre për shkak të konkurrencës nga qendrat e mëdha tregtare që tani janë funksionale në qytet tona.
Ndërsa te institucionet përqindja e inkasimit është problem ndarja e buxhetit për komunali dhe për këtë institucionet pagesat nuk po i kryejnë konform detyrimeve të tyre ndaj kompanisë.
Pavarësisht këtyre që u cekën më lart kompania duhet që në vitet pasuese ta shtoj presionin ndaj borxhlinjve për mes dorëzimit të vërejtjeve për shkyçje, shkyçjeve si dhe paraqitjen-dorëzimin e lëndëve të borxhlinjve në gjykatë kompetente.
Kompania në vazhdimësi inkurajon dhe mbështet idetë dhe politikat te cilat ndihmojnë ne përmirësimin e shkalles se arkëtimit.

7. PLANI FINANCIAR

7.1 Plani i financimit kapital

Për shkak të mos pagesës së plote për shërbimet e ofruara konsumatorëve, kompania ka vështirësi financiare që të bëjë vet financimin e projekteve kapitale për ujësjellës dhe ujërave të zeza.
Kryesisht investimet po bëhen nga donatorët si:Donatoret e huaj , Qeverie, Komuna dhe komuniteti për të cilët bëhet investimi.

7.2 Kërkesat vjetore operative dhe të hyrat kapitale

Funksionimi normal i Kompanisë, dhe ofrimi i shërbimeve cilësore dhe me kohe karshi konsumatorëve, në vitin 2018, kërkon mjete financiare për mbulimin e shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes, e të cilat mjete i siguron nga kërkesat financiare të arkëtuara nga konsumatorët të cilëve ju ofron shërbime.

Në vitin 2018 prap do të merret parasysh ne vazhdimesi qe të mos ketë punë (orë) shtese jashtë orarit te punës, por me një organizim më të mire të gjitha punët të kryhen brenda orarit të rregullt të punës, edhe puna motivuese (stimulimi) te punëtorët të rregullohet me vendim për pagesën e punëve të kryera, kjo do të ndikoj në uljen e pagesës së orëve shtesë.
Mjetet financiare të siguruara, me të cilat financohen shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes, janë kryesisht mjete vetanake.

Shpenzimet sipas kategorive:
Tabela 1 '000

	Emërtimi I shpenzimit	2016	2017	2018	2019	2020
1	Shpenzimet e energjisë	240	240	260	270	280
2	Shpenzimet e kemikaleve	23	24	28	33	34
3	Shpenzimet e derivateve	36	30	34	34	38
4	Shpenzimet e pagave	1,029	1,104	1,204	1,280	1,312
5	Shpenzimet e materialit administrativ	15	9	10	10	11
6	Shpenzimet e per sigurime dhe rexhistrime te automjeteve	7	7	8	8	10
6	Shpenzimet e mirëmbajtjes	15	74	86	104	108
7	Shpenzimet e shërbimeve të kontraktuara/ auditim/konsulatant	61	59	60	62	65
8	Shpenzimet e qirase, tel, mbeturina dhe tatime	40	21	23	25	26
9	Shpenzimet tjera direkte	80	44	48	50	55
	Gjithsej	**1,546**	**1,612**	**1,761**	**1,876**	**1,939**

'000



Nga tabela e lart shënuar shohim rritje të shpenzimeve në çdo vit, kjo na bën të kuptojmë se çdo vit kemi rritje të aktiviteteve për ofrimin e shërbimeve sa më cilësore konsumatorëve, në këtë rritje ndikojnë dhe rritja e çmimeve të tregut.

8. PLANI KOMERCIAL

8.1 Politikat dhe programet e Matjes

Në vitin 2018 planifikohet inkasim 83.40 % nga faturimi, krahas inkasimit 82.00 % sa parashihet të mbyllim vitin 2017, ku do të jemi më këmbëngulës në realizimin (inkasimin) e mjeteve tona financiare nga borxhlit të cilët nuk i paguajnë faturat për shërbimet e pranuara nga kompania, këtë do ta bëjmë me shkyçje individuale sipas rasteve dhe shkyçje kolektive, sipas nevojës edhe me asistimin e Policisë së Kosovës, gjithnjë duke i respektuar rregulloret në fuqi të ARRU-së për shkyçje të konsumatorëve.
Konsumatorët të cilët i heqin pllombat do ti padisim në gjykatë për dëmtim të pllombës-ujëmatësit dhe të njëjtit do të ndëshkohen konform kodit penal të Kosovës.
Në vitin 2018 do ta mundohemi te zgjerojme rrjetin e sistemit te pagesave.Pagesat e punonjësve – inkasantëve dhe lexuesve do të bëhen sipas rezultateve të arritura në punë, duke u bazuar në planin e normës së inkasimit dhe leximit.

8.2 Evitimi i lidhjeve ilegale/fiktive/pasive

Rregullimi i lidhjeve ilegale do të bëhet në bazë të informatave që i sjellin (sigurojnë) punëtorët-lexuesit tanë nga tereni, por edhe me vet lajmërimin nga konsumatorët që deri më tani ishin ilegal.
Në identifikimin e konsumatorëve ilegal në vitin 2018 do të na shërbej shumë dhe sistemi i GIS-it, për mes të cilit do të bëhet identifikimi më i lehtë i konsumatorëve ilegal. Lexuesit dhe inkasantët i kanë të përshkruara në detyrat e punës për zbulimin e lidhjeve ilegale, aktivizimin e lidhjeve pasive, në të kundërtën do të japin përgjegjësi për mos kryerje të punëve.

8.3 Përmirësimi i faturimit të bazës së konsumatorëve

Faturimi i konsumatorëve bëhet duke u bazuar në leximin e ujëmatësve, por ku nuk ka mundësi vendosja e ujëmatësve faturimi bëhet në bazë të paushallit sipas udhëzimit të ARRU-se, varësisht se cilës kategori i takon konsumatori, udhëzimi i ARRU-së për faturimin e konsumatorëve me paushall dhe vendosja e ujëmatësve na banesat kolektive po ashtu ka ndikuar që të rritet faturimi këtë vit krahas vitit të kaluar.
Në vitin 2018 do ti inkurajojmë të gjithë konsumatorët-shtëpitë dhe bizneset e vogla të cilët nuk kanë apo i kanë jo funksional që t'ju vendosim ujëmatësit në mënyrë që ti ikim faturimit paushall sipas sasive të vendosura sipas AARU-së.

Faturimi ne € sipas viteve '000

Sipas tabelës të shënuar më lartë shohim rritje të faturimit sipas viteve, kjo rritje është rezultat i shtimit të numrit të konsumatorëve.

8.4 Arkëtimi i të ardhurave

Inkasimi në vitin 2018 do të jetë 2,026 mijë € apo 83.40%, , në këtë vite përkundër përqindjes më të lartet, në sasi pritet të kemi më shumë mjete financiare të inkasuara se viti paraprak.
Në rritjen e inkasimit do të ndikoj dhe leximi më i shpeshtë dhe më i saktë i ujëmatësve, ku konsumatorët do të kenë fatura sipas harxhimit mujor gjatë leximit identifikohen dhe lidhjet e dyfishta ku pastaj ekipet të njëjtat i eliminojn-shkyçin, por nëse konstatohet manipulimi me ujëmatës konsumatorët do të paditen në gjykatë dhe të përgjigjen sipas kodit penal.
Në ngritjen e inkasimit do të ndikoj dhe fuqizimi i ekipeve të shkyçjes duke ju bërë presion konsumatorëve borxhli.
Po ashtu në rritjen e inkasimit do të ndikoj forma e pagesave në arkat e kompanisë të cilat janë të shpërndara në pjesë të ndryshme të qytetit, si dhe pagesat për mes llogarive bankare.

	Përqindja e inkasimit			
	2016	2017	2018	2019
Arkëtimi -përgjithshëm	77.33	82.44	83.00	84.00
Arkëtimi-Amvisnit	72.00	79.00	80.00	81.00
Arkëtimi-Joamvisrit	94.00	95,00	96.00	97.00



Skema tregon se inkasimi sipas përqindjes dallon nga kategoria e konsumatorëve në kategori, amvisëria është kategori ku pritet inkasim më i ulët duke u bazuar në gjendjen sociale të tyre jo të kënaqshme. Por te kategoria jo amvisnit-bizneset e mëdha pritet rritje e theksuar e inkasimeve, duke u bazuar në aktivitetet e tyre afariste besojmë se do ti kryejnë detyrimet e tyre për ujin e konsumuar.

Ndërsa institucionet i kanë mjetet – fondet financiare të alokuara për komunali por kompetentët e institucioneve duhet që të planifikojnë mire mjetet për komunali- ujë, dhe pastaj t'ju rrinë gati faturave për shërbimet e pranuara nga kompania dhe ato ti paguhen sipas muajve.

9. PLANI I INVESTIMEVE KAPITALE: 2017-2019

Projekt propozimet e paraqitura ne infrastrukture për periudhën 2017-2019 kane rëndësi te veçantë për kompaninë Hidromorava sidomos ne uljen e humbjeve te ujit te cilat aktualisht sillen diku 57% nga sasia e ujit te prodhuar. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre humbjeve u takojnë pikërisht humbjeve që vijne direkt nga rrjeti i amortizuar qe ne te shumtën e rasteve e kalon moshën 45 vjeçare dhe se i gjithë rrjeti I cili propozohet për ndërrim është nga materiali Azbest Cement dhe Zingu.

ID,01 e Projektit, titulli dhe lokacioni:	1. Akreditimi i Laboratorit kryesor , paisjet dhe inventari prane KRU Hidromorava Gjilan 2. Inventarizimi i objektit per mirembajtjen e ujesjellsit dhe kanalizmit
Afati kohor implementimit:	Viti: 2018
Vlera e përllogaritur:	€ 85,000
Burimi i financimit:	KRU Hidromorava Sh.a (Gjilan, Viti dhe Kamenicë)
Përshkrimi dhe qëllimi i projektit:	Me ndërtimin e Laboratorit qëndror kompania parasheh që të bëj inventarizimin e laboratorit per analiza fikio-kimike dhe bakteriologjike. Ky projekt eshte i rendeishem per kompanine ngase sipas udhezimit administrativ 16/2012 KRU Hidromorava eshte e obliguar qe analizat ti kryej ne nje laboratot të akredituar qoftë në kuadër të Kompanisë vet apo prej ndonjë kompanie të licencuar.

ID,02 e Projektit, titulli dhe lokacioni:	Paisjet mobile per lexim te Ujematesve per Njesine e Gjilanit
Afati kohor implementimit:	Viti: 2018
Vlera e përllogaritur:	€40,000
Burimi i financimit: Profili ekzistuet i asetit	KRU Hidromorava. SH.A, Gjilan
Përshkrimi dhe qëllimi i projektit:	Me qëllim të efikasitetit të punës si dhe braktisjes se leximit ne menyre mekanike si dhe ne anen tjeter ngrritjes së përqindjes së faturimit përmes paisjeve me teknologji më të avansuar. Pasi qe eshte realizuar nje projekt qe ka perfshire 4 zona , ne jemi te interesuar te perfshijme edhe zonat e tjera ne menyre qe te ngritet performanca e kompanise , duke pasur parasysh qe baza per suksesin tone eshte faturimi i ujitprej te cilit varen te gjithe treguesit e kesaj kompanie .

ID,03 e Projektit, titulli dhe lokacioni:	Ripertrirje e rrjetit ekzistues ujësjellës e Gjilanit Lloto III- Gjatesia L= 7 km'
Afati kohor implementimit:	Viti: 2018
Vlera e përllogaritur:	€ 300,000
Burimi i financimit: Projekti:	Është planifikuar investim i përbashkët nga Qeveria e Kosovës- Ministria e Zhvillimit Ekonomik Ekziston projekti ideor, ndërsa projekti detal do te përgatitet me zotimin e mjeteve për këtë projekt.
Përshkrimi dhe qëllimi i projektit:	Pjesa e qytetit nga Hoteli "Kristal" deri te ETC-ja, si dhe rrugët anësore Elez Agushi dhe Makfire Deda. Ndërrimi i rrjeti te vjetër te ujësjellësit, kyçjeve dhe ujëmatësve të vjetër dhe vendosja e rrjetit te ri duke përfshirë, kyçjet dhe ujëmatësit e ri të ujësjellësit. Rrjeti i ujësjellësit ne këtë zonë të Qytetit është i vjetruar (mbi 45 vjet), materiali Azbest Cement dhe mjaft i amortizuar. Humbjet e ujit janë te larta si pasoje e defekteve te paraqitura për shkak te presioneve te larta te ujit, po për këtë shkak edhe implikimet financiare te kompanisë ne mirëmbajtjen e rrjetit kane qene te larta. Rendësi tjetër shume e veçantë për prioritetin e këtij projekti është fakti i qe kjo zone tani për tani është me e populluara ne Qytet për sa i përket frekuentimit te konsumatorëve si qendra tregtare si dhe ndërtime te reja te banesave

ID,04 e Projektit dhe Titulli:	Paisjet e klorizimit te ujit
Afati kohor implementimit:	Viti:2018
Vlera e përllogaritur:	50,000€
Burimi i financimit:	KRU Hidromorava. SH.A, Gjilan
Përshkrimi dhe qëllimi i projektit:	Sistemet per dezinfektim te ujit ne pikat kryesore Perlepnice , Baja dhe sistemet e Pompimit ne Kamenice aktualisht nuk jane ne gjendje te mire per sa i perket dezinfektimit te ujit . Keto sisiteme jane amortizuar shume dhe kerkohet nje rehabilitim apo ndertim te sistemeve te reja . Ky projekt do te mundesoj rritjen e kualitetit te ujit ne gjithe zonen e sherbimit qe menaxheihet nga KRU Hidromorava.

ID,05 e Projektit dhe Titulli:	Ndërrimi – Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit
Afati kohor implementimit:	Viti:2018
Vlera e përllogaritur:	30,000€
Burimi i financimit:	KRU Hidromorava. SH.A, Gjilan
Përshkrimi dhe qëllimi i projektit:	Duke marre parasysh qe rrjeti i kanalzimit eshte i aportizuar dhe disa oika vazhdimisht paraqesin probleme ne bllokim te gypave , kompania parasheh te beje rehabilitimin – nderrimin e ketyre gypave ne baze te kerkesave te konsumatoreve apo edhe te evidences qe disponon kompania.

ID,06 e Projektit dhe Titulli:	Blerja e Kamiontes
Afati kohor implementimit:	Viti:2018
Vlera e përllogaritur:	10,000€
Burimi i financimit:	KRU Hidromorava. SH.A, Gjilan
Përshkrimi dhe qëllimi i projektit:	Ky auto mjet do te sherbej per mirembajtje te dy sektorve si ne rrjet te ujesjellsit ashtu edhe ne rrjetin e kanalizimit , duke pas parasysh qe KRU Hidromorava do te zgjeroj zonen e sherbimit dhe ne kater komuna te reja.

ID,07 e Projektit dhe Titulli:	Rikonstruimi i kulmit ne stacionin Baja – Gjilan
Afati kohor implementimit:	Viti:2018
Vlera e përllogaritur:	8,000€
Burimi i financimit:	KRU Hidromorava. SH.A, Gjilan

Përshkrimi dhe qëllimi i projektit:	Kulmi i stacionit te pompimit Baja eshte ne gjendje shume te keqe pasi eshte demtuar shume izolimi i kulmit dhe gjate reshjeve uji deperton ne stabilimentet elektrike duke rrezikuar punen e pompave po ashtu edhe stafin punonjes- operatoret .

ID,08 e Projektit dhe Titulli:	Blerja e GPS- instrument per matjen e elevacionit me kordinata ne sistemin Gjeografik
Afati kohor implementimit:	Viti:2018
Vlera e përllogaritur:	7,000€
Burimi i financimit:	KRU Hidromorava. SH.A, Gjilan
Përshkrimi dhe qëllimi i projektit:	Blerja e një instrumenti me te avancuar GPS- mund te ndihmoje kompaninë sidomos zyrën e GIS-t për kryerjen e punëve me mire e me saktë. Përmes këtij instrumenti do te mund te përgatiten hartat si për rrjetin e ujësjellësit po ashtu edhe kanalizimit si edhe për te gjithë infrastrukturën tjetër e cila gjendet brenda zonës se shërbimit te KRU Hidromorava ne Gjilan.

ID,09 e Projektit dhe Titulli:	Investimet ne DMA zone – Gjilan .
Afati kohor implementimit:	Viti:2018
Vlera e përllogaritur:	€ 70,000
Burimi i financimit:	KRU Hidromorava – Gjilan
Projekti: Përshkrimi dhe qëllimi i projektit:	Me qellim te zvogelimit te UPF-se ne zonen e sherbimit kRU hIdromorava ka planifikuar te invstoj ne nje zone Pilot ne qyetetin e Gjilanit duke perfshire montimin e Ujematesve per kosnumatore , Ujematsve Zonal, rehabilitimin e rrjetit ekzistues , vendosjen e data llogereve per matjen e prodhimit online si dhe ndertimin e pusetave te nevojshme . Madhesia e zones do te jete afersishte 1,500 konsumatore .

ID,10 e Projektit dhe Titulli:	Shtimi i kapaciteteve te ujit për qytetin e Kamenices dhe rivitalizimi i stacionit te pompave
Afati kohor i implementimit	Viti:2018
Vlera e përllogaritur:	€ 240.000.00
Burimi i financimit:	Është planifikuar investim i përbashkët nga Qeveria e Kosovës- Ministria e Zhvillimit Ekonomik ne bashkëpunim me Komunen .
Përshkrimi: Përshkrimi dhe qëllimi i projektit:	Ndërtimi i kaptazhes për kaptimin e ujit ne pellgun e lumit Kamenica, 1500 m' mbi stacionin e pompimit nr. 1 do te përmirësoje dukshëm furnizimin me ujë për qytetin e Kamenicës. Projekti parasheh ndërtimin e kaptazhes dhe gypit transportues nga kaptazha deri te stacioni i pompimit nr 1. Me këtë projekt përpos shtimit te kapacitetit do te rritet edhe kualiteti i ujit ngase do te eliminohet mundësia e rrezikut te ndotjes nga gurthyesi i cili gjendet mbi stacioni nr 1. Projekt tjetër me rendësi për këtë komune është parapare edhe investimi ne rivitalizimin e sistemit te pompimit ne stacionin 1 dhe 2. Investimi ne këto stacione do te krijonte kushte qe njësia operative te operonte pa shpenzime te larta operative dhe qe ne te ardhmen vet ti mbuloje shpenzimet operative.

ID,11 e Projektit dhe Titulli:	Ndërtimi i gypit te ri nga fabrika Vinex ne Viti ne drejtim te Kllokotit ne gjatesi L=4000m', përgjatë dy aneve te rruges
Afati kohor i implementimit	Viti:2018
Vlera e përllogaritur:	€80,000.00
Burimi i financimit:	Është planifikuar investim i përbashkët nga Qeveria e Kosovës- Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Komuna apo Donatoret
Përshkrimi: Përshkrimi dhe qëllimi i projektit:	Ekziston projekti ideor, ndërsa projekti detal do te përgatitet me zotimin e mjeteve për ketë projekt Ndërtimi i rrjetit te ri ne gjatesi L= 2000 me diameter afersisht 125 mm mm, do te ketë një rëndësi te posaçme për qytetin sidomos për kete pjese te qytetit pasi qe sipas planit rregullues te qytetit kjo zone eshte percaktruar te jete si zone industriale e qytetit. Pashtu, per Nj. Operative ne Viti dhe per KRU Hidromorava ne pergjithesi ky projekt do te jete fitimprures per shkak te zgjerimit te zones se sherbimit me konsumator biznesi te cilet ne te shumten e rasteve jane konsumator qe shpenzojne dhe paguaj ujin e shfrytezuar. Materiali i gypit qe planifikohet te vendoset eshte PE-RC.

ID,12 e Projektit dhe Titulli:	Ndërtimi i pendës te **„Shusht"**- Viti
Afati kohor i implementimit	Viti:2018
Vlera e përllogaritur:	€ 30, 000,000.00
Burimi i financimit:	I jashtem Ekziston projekti ideor,
Përshkrimi: Përshkrimi dhe qëllimi i projektit:	Ekziston projekti ideor, ndërsa projekti detal do te përgatitet me zotimin e mjeteve për ketë projekt Projekti ka karakter Rajonal dhe do të bëjë furnizimin me ujë të pijes dy qytete të Anamoravës Gjilanin dhe Vitin si dhe fshatrat që shtrihen për rrethë ktyre qyteteve. Ndërtimi i pendës planifikohet të bëhet në rrjedhen e Lumit Morava e Binqës brenda kuotave 560 dhe 620 lmd, konkretisht 2-3km mbi fshatin Binqë. Trupi i pendës te "Shusht" do te jetë e lartë h=60m me një kapacitet max. V= 23000000m^3 sasi kjo që do te jetë e mjaftueshme per 30 vjetet e ardhëshme për këto dy komuna. Nga akumulacioni i pendës uji do të përcillet permes gypit Ø600 mm me gravitet me gjatësi L=25 km' deri ne afersi te fshatit Velekinc ku do të ndërtohet stacioni i pompimit për ta derguar ujin në rezervarin e ri i cili planifikohetë ndërtohet në kodren e Velekinces në koten mbitare 591 lmd me një kapacitet V= 5000m^3. Nga kjo pike do të bëhet lidhja e ujit me anë të gypit me gravitet Ø 600 mm me rezervarin ekzistues në Kodren e Dëshmorve dhe një pjesë tjetër do ë jtë e kyqur në rrjetin e ujësjellsit. Perpos qytetit të Gjilanit sistemi do të bëjë furnizimin me ujë edhe për qytetin e Vitis. Eshte me rendesi te ceket se para fillimit te qfardo pune duhet te kemi nje Studium Fizibiliteti per kete project duke pare parasyshe ne komleksitetin e ketij projekti dhe ndikimin e tij ne rajonin e anamoraves.

ID,13 e Projektit dhe Titulli:	Ripertrirja e rrjetit ekzistues L=7,000m'-Gypi nga FPU- Perlepnicë deri ne hyrje te qytetit ne Perlepnice.
Afati kohor implementimit:	Viti:2019-2020
Vlera e përllogaritur:	€900,000.00
Burimi i financimit:	Është planifikuar investim i përbashkët nga Qeveria e Kosovës-Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Komuna apo Donatoret
Projekti: Përshkrimi dhe qëllimi i projektit:	Ekziston projekti ideor, ndërsa projekti detal do te përgatitet me zotimin e mjeteve për ketë projekt Gypi kryesor aktual i ujësjellësit me gjatesi L= 7000m' dhe me diameter Ø400mm i cili bene transportimin e ujit nga FPU ne Perlepnice deri ne Qytet ka nevoje qe te ndërrohet për shume arsye. Mosha mbi 40 vjeç dhe mjaft i amortizuara, një pjesë e humbjeve te ujit ne sistem konsiderohen te jene ne ketë segment. Eliminimi i kyçjeve ilegale te mundshme ne ketë gyp ngase gypi kalon ne pjesën ku kemi një zhvillim te konsiderueshëm te biznesit. Aftësia jo e mjaftueshme për përcjelljen e ujit ne sasi kur kërkesat e pikut janë te larta, për ketë arsye kemi edhe mungesa te presioneve te ujit ne pika te larta te qytetit edhe kur kemi sasi te mjaftueshme ne burime ekzistuese te ujit. Ndërrimi i këtij gypi dhe vendosja e një gypi te ri nga materiali PE- RC, me profil me te madhe DN-600mm do ti eliminonte te gjitha këto probleme te cilat aktualisht paraqiten si dhe do te rregullohej edhe furnizimi me ujë i te bizneseve te cilat gjinden ne aksin e rrugës për Bujanoc.

ID,14 e Projektit dhe Titulli:	Ndërtimi i gypit te ri nga fabrika e IBG- Gjilan L=7,500m', përgjatë rrugës qarkore deri te rezervuari ne Kodrën e Dëshmorëve.
Afati kohor implementimit:	2019-2020
Vlera e përllogaritur:	€750,000.00
Burimi i financimit:	Është planifikuar investim i përbashkët nga Qeveria e Kosovës-Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Komuna apo Donatoret
Projekti: Përshkrimi dhe qëllimi i projektit:	Ekziston projekti ideor, ndërsa projekti detal do te përgatitet me zotimin e mjeteve për ketë projekt Ndërtimi i rrjetit te ri ne gjatesi L= 7.500m' me diameter 350mm, do te ketë një rëndësi te posaçme për qytetin sidomos për lagjet: Dheu i Bardhe, Dardania I dhe II , Rruga e Prishtinës si dhe Kodra e Dëshmorëve. Me ketë do te eliminoheshin problemet e furnizimit me ujë për pikat e larta te qytetit ngase furnizimi me ujë do te arrihej ne mënyrë direkte përmes këtij gypi. Nga rezultatet e studimit me modelim hidraulik ka dale se presionet ne pika kritike do te rriteshin

	nga 0.5 bar ne 3,5 bar ndërsa pikat kritike me presione te larta mbi 7 bar do te amortizoheshin. Materiali i gypit qe planifikohet te vendoset eshte PE-RC.

ID, 15 e Projektit dhe Titulli:	Ripertrirje e rrjetit ekzistues ujësjellës: lagjen "Dardania I" Gjilan
Afati kohor implementimit:	Viti:2020
Vlera e përllogaritur:	€450,000.00
Burimi i financimit: Projekti:	Është planifikuar investim i përbashkët nga Qeveria e Kosovës- Ministria e Zhvillimit Ekonomik ne bashkëpunim me Komunen . Ekziston projekti ideor, ndërsa projekti detal do te përgatitet me zotimin e mjeteve për këtë projekt
Përshkrimi dhe qëllimi i projektit:	Pjesa e qytetit Lagja Dardania I. Ndërrimi i rrjeti te vjetër te ujësjellësit, kyçjeve dhe ujëmatësve të vjetër dhe vendosja e rrjetit te ri duke përfshin, kyçjet dhe ujëmatësit e ri të ujësjellësit. Kjo pjese e qytetit është nder te rrallat ne qytet e cila është ndërtuar sipas planit rregullativ urban. Rrjeti i ujësjellësit është i vjetruar (mbi 40 vjet), materiali Azbest Cement dhe mjaft i amortizuar. Humbjet e ujit janë te larta si pasoje e defekteve te paraqitura po ashtu ka presione te ulëta te ujit ne rrugët e fundit te për shkak te këtyre defekteve.

ID,16 e Projektit dhe Titulli:	Ripertrirje e rrjetit ekzistues ujësjellës L=2,000m': nga Qendra Tregtare Agmia deri te udhëkryqi i rrugës Jugu 1
Afati kohor implementimit:	Viti:2020
Vlera e përllogaritur:	€250.000.00
Burimi i financimit: Projekti:	Është planifikuar investim i përbashkët nga Qeveria e Kosovës- Ministria e Zhvillimit Ekonomik ne bashkëpunim me Komunen Ekziston projekti ideor, ndërsa projekti detal do te përgatitet me zotimin e mjeteve për këtë projekt
Përshkrimi: Përshkrimi dhe qëllimi i projektit:	Gypi ekzistues aktual është Ø250mm AC dhe konsiderohet si gyp me humbje te konsiderueshme te ujit, po ashtu gypi kalon neper prona dhe objekte banimi. Realizimi i këtij projekt do të mundësonte transportimin e ujit dhe do te eliminonte problemet pronësore qe aktualisht janë te paraqitura gjate trasesë. Planifikohet te vendoset gypi me diameter DN 350mm me material, PE-RC.

ID,17 e Projektit dhe Titulli:	Ndërtimi i fabrikes per trajtimin e ujrave te zeza (WWTP)
Afati kohor implementimit:	Viti:2020
Vlera e përllogaritur:	€ 26.000 000.00
Burimi i financimit: Projekti:	Është planifikuar investim i përbashkët nga Qeveria e Kosovës, Donator dhe ne bashkëpunim me Komunen. Ekziston projekti i Fizibilitetit, ndërsa projekti detal do te përgatitet me zotimin e mjeteve për këtë projekt
Përshkrimi: Përshkrimi dhe qëllimi i projektit:	Objekti per trajtimin e ujrave te zeza planifikohet te ndertohet ne afersi te fshatit Uglar, si pike me e ulet dhe e pershtatshme per per grumbullimin e te gjithe kolektoreve ne nje pike te vetme. Projekti ka karakter multi dimensional për KRU Hidromorava ne Gjilan. Projekti do te trajtoj kapacitetet e rrjetit ekzistues te kanalizimit, rrjetin e planifikuar, zëvendësimin e gypave ekzistues

8.1 Rekapitullimi i te gjitha projekteve 2016-2018

NR	ID e Projektit dhe Titulli	Vlera e përllogaritur
1	-Akreditimi i Laboratorit Kryesor , pasijet dhe inventari - Inventarizimi i objektit per mirembajtjen e ujesjellsit dhe kanalizmit	85,000. 00 €
2	Paisjet Mobile per lexim te Ujematesve	40, 000.00 €
3	Ripertrirje e rrjetit ekzistues ujësjellës e Gjilanit Lloto III- Gjatesia L= 7 km'	300 000.00 €
4	Paisjet e korizimit te ujit	50,000.00 €
5.	Ndërrimi – Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit	30,000.00 €
6.	Blerja e Kamiontes	10,000.00 €
7	Rikonstruimi i kulmit ne stacionin Baja – Gjilan	8,000.00 €
8	Blerja e GPS- instrument per matjen e elevacionit me kordinata ne sistemin Gjeografik	7,000.00 €
9	Investimet ne DMA Zone – Gjilan	70,000.00 €
10		

	pompave	
11	Ndërtimi i gypit te ri nga fabrika Vinex ne Viti ne drejtim te Kllokotit ne gjatesi L=4000m', përgjatë dy aneve te rruges	80,000.00 €
12	Ndërtimi i pendës te **„Shusht"**- Viti	30,000,000.00 €
13	Nderrimi i Gypit nga FPU- Perlepnicë deri ne hyrje te qytetit ne Perlepnice.	900 000.00 €
14	Ndërtimi i gypit te ri nga fabrika e IBG- Gjilan, përgjatë rrugës qarkore deri te rezervuari ne Kodrën e Dëshmorëve.	750 000.00 €
15	Ripertrirje e rrjetit ekzistues ujësjellës: lagjen "Dardania I" Gjilan	450,000.00 €
16	Ripertrirje e rrjetit ekzistues ujësjellës: nga Qendra Tregtare Agmia deri te udhëkryqi i rrugës Jugu 1	250 000.00 €
17	Ndërtimi i fabrikes per trajtimin e ujrave te zeza TP)	26 000 000.00 €
	Totali:	**58,430,000.00 €**

Me 28 Tetor 2017
Gjilan

Kryesuesi i Bordit te Drejtoreve
Znj. Elhame Shefkiu